



**UNIVERSITETI I TETOVËS**  
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës

Në bazë të Vendimit me numër 13-354/2, të datës 05.06.2023 për formimin e Komisionit për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës, me titull "**Shkaqet, format e manifestimit dhe parandalimi i kriminalitetit të fëmijëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut**", të kandidates Mr. sc. Nazmije Shaqiri, Komisioni në përbërje: Prof.dr. Qebir Avziu, Prof. Dr. Arta Bilalli, Prof. Dr. Fatbardha Ismaili, Prof. Dr. Ali Musliu dhe Prof. Dr. Afrim Osmani - mentor, pasi lexoi materialin në dorëshkrim, Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Juridik i paraqet këtë

**R A P O R T**  
**për vlerësimin e disertacionit të doktoratës**

Punimi i disertacionit të doktoraturës së kandidates **Nazmije Shaqiri** i plotëson kriteret e një punimi të mirëfilltë të doktoraturës si në aspekt strukturor po ashtu edhe në aspekt përbajtësor dhe hulumtues-shkencor.

**Lënda e hulumtimit:**

Kriminaliteti i fëmijëve si një shqetësim shoqëror preokupon edhe vendin tonë dhe këtë e dëshmojnë edhe të dhënrat zyrtare në lidhje me prevalencën e kësaj dukurie. Raportimet zyrtare paraqesin të dhëna rrëth përhapjes së sjelljeve kriminale të fëmijëve, megjithatë nuk mundëson një pasqyrë të qartë rrëth faktorëve nxitës të këtyre sjelljeve. Në vendin tonë janë të pakta studimet që kanë pasur fokus eksplorimin e përvojave dhe qëndrimeve të fëmijëve kryes të veprave penale të cilëve iu është shqiptuar masa Referim në Shtëpi edukuese përmirësuse dhe

nxënësve të moshës 14-18 vjeçare rrëth vlerësimit të faktorëve endogjen dhe ekzogen në të cilën ata janë ekspozuar dhe të cilat mund ti nxisin ata të përshihen në sjellje që bien ndesh me ligjin.

Është shqetësues edhe fakti se së fundmi, struktura e kriminalitetit të fëmijëve po i afrohet strukturës së kriminalitetit të të rriturve, duke marrë për bazë veprat penale me rrezikshmëri të lartë të cilët janë duke i kryer edhe fëmijët. Kjo bazohet në hulumtimet bashkëkohore mbi fenomenologjinë e kriminalitetit të fëmijëve, ku shohim se fëmijët sot po shfaqen gjithnjë e më shumë si autorë të veprave më të rënda penale siç janë: vrasjet, përdhunime, vjedhje të rënda, lëndime të rënda trupore të cilat i kryejnë vetë ose të përfshirë në banda, gjë që imponon një qasje shumë më serioze nga studijues nga fusha të ndryshme në banda, gjë që identifikimin e faktorëve të rrezikut dhe studimit të karakteristikave fenomenologjike me qëllim që të ndërmerren masa për parandalim efektiv dhe risocializimin e fëmijëve.

Për të analizuar shkaqet të cilat shpien një fëmijë që të përfshihet në sjellje kriminale duhet të verifikohet marrëdhënia mes faktorëve të ndryshëm demografik, social, personal dhe ekonomik me tendencën e fëmijëve për të kryer vepra penale. Kjo do të analizohet edhe përmes studimit cilësor që ka për qëllim të eksplorojë dukurinë e kriminalitetit të fëmijëve nga këndvështrimi i vetë fëmijëve që kanë kryer vepra penale dhe ekipi profesional që punon aktualisht me ta.

Për më tepër, arsyetimi dhe rëndësia e studimit të kësaj dukurie qëndron në atë se përmes një studimit të detajuar të karakteristikave etiologjike të kriminalitetit të fëmijëve do të tentohet të jepet përgjigje disa pyetjeve kërkimore në lidhje me faktorëve të rrezikut nga fusha personale, bashkëmoshatarëve, shkollës dhe komunitetit të cilët i kontribuojnë kriminalitetit të fëmijëve, dhe duke dhënë informacione në lidhje me objektivat e studimit do të ofrohen rekomandimet për zhvillimin e politikave dhe strategjive të përshtatshme për ta minimizuar këtë dukuri.

Rëndësia tjetër e këtij studimi janë vlefshmëria e rezultateve të këtij kërkimi të cilat bazohen nga të dhëna empirike të mbledhura nga instrumentet e përdorura për studimin cilësor dhe sasior siç është pyetësori dhe intervistat.

Studimi duke përfshirë dy grupe adoleshentesh eksploroni përvojat dhe qëndrimet e fëmijëve në konflikt me ligjin të institucionalizuar dhe nxënës të shkollave fillore dhe të mesme në familje, shkollë, komunitet, me moshatarët e tyre duke vlerësuar se si këto faktorë rreziku kanë ndikuar në sjelljet e tyre deri më tanë. Studimi ka vlerë edhe për institucionet të cilët merren me trajtimin e fëmijëve si kryes të veprave penale, jo vetëm për analizën teorike por edhe për gjetjet empirike që ky studim ka nxjerrë në pah.

Së fundmi, ky studim përbën një kontribut hulumtues në fushën e drejtësisë për fëmijë dhe hap horizonte të reja për studime të mëtejshme mbi çështje të caktuara që lidhen me kriminalitetin e të miturve në vendin tonë, duke nisur nga faktorët kyç parashikues të kriminalitetit të fëmijëve; mënyra e manifestimit të veprave penale; pozita juridike e fëmijës si kryes i veprave penale; sanksionet penale që iu shqiptohen; risocializimi me qëllim final reflektimin mbi ndërmarrjen e masave efektive për parandalimin e kriminalitetit të fëmijëve.

### **Qëllimi i studimit**

Qëllimi kryesor i këtij studimi shkencor është të verifikojë marrëdhënien mes faktorëve të ndryshëm demografik, social, personal dhe ekonomik me tendencën e fëmijëve për të kryer vepra penale. Ky studim ka synuar që të gjejë lidhjen mes faktorëve nga fusha e familjes (struktura familjare, punësimi i prindërve; historia kriminale e prindërve, raporti dhe mbështetja emocionale dhe kujdesi prindëror; abuzimi i fëmijëve, kontrolli prindëror; përjetimi i ngjarjeve të rënda në familje), fusha personale (përjetimi i kërcënimeve dhe dhunës); siguria në shkollë; përdorimi i internetit; fusha e bashkëmoshatarëve (sjellje antisociale të bashkëmoshatarëve, përfshirja në banda); fusha e komunitetit (siguria në lagje; reagimi i komunitetit ndaj sjelljeve të fëmijëve në studim) me shkallën e tendencës për kryerjen e veprave penale. Studimi cilësor ka për qëllim të eksplorojë dukurinë e kriminalitetit të fëmijëve nga këndvështrimi i vetë fëmijëve që kanë kryer vepra penale dhe ekipi profesional që punon aktualisht me ta.

Bazuar në rishikimin e literaturës të këtij punimi dhe studimeve të ngjajshme të prezantuara më lartë, për çdo qëllim dhe pyetje kërkimore janë paraqitur hipotezat e kërkimit si më poshtë:

H<sub>1</sub> - Fëmijët që nuk kanë raporte të mira familjare, kanë tendencë për të kryer më tepër vepra penale se sa fëmijët të cilët kanë marrëdhënie të mira familjare.

H<sub>1.2</sub> - Fëmijët të cilët jetojnë me njërin prind janë më të prirur për të kryer vepra penale, në krahasim me fëmijët që jetojnë me të dy prindërit.

H<sub>1.3</sub> - Fëmijët të cilët i kanë prindërit e punësuar kanë më shumë gjasa për të kryer vepra penale, se sa fëmijët të cilët nuk i kanë prindërit e punësuar rrregullisht.

H<sub>1.4</sub> - Ekziston korrelacion negativ në mes të ardhurave në familje dhe kryerjes së veprave penale. Të ardhurat e ulëta në familje, shoqërohen me rritjen e kryerjes së veprave penale.

H<sub>1.5</sub> - Sa më i lartë të jetë monitorimi i prindërve ndaj fëmijëve, aq më e ulët është përfshirja e tyre në veprime që bien ndesh me ligjin

H<sub>1.6</sub> - Fëmijët të cilët kanë kanë përjetuar ngjarje të rënda në familje, kanë më shumë tendencë të kryejnë vepra penale, krahasuar me fëmijët që nuk kanë përjetuar.

H<sub>2</sub> - Fëmijët meshkuj kryejnë më shumë vepra penale në krahasim me fëmijët e gjinisë femërore

H<sub>3</sub> - Ekziston lidhje domethënëse në mes tendencës për kryerjen e veprave penale të fëmijët me shkallën e sjelljeve devijuese të shoqërisë së tyre.

H<sub>4</sub> - Fëmijët të cilët kanë kanë qenë viktima të dhunës, kanë më shumë tendencë të kryejnë vepra penale, se sa fëmijët që nuk kanë qenë viktima

H<sub>5</sub> - Sa më të theksuara të jenë veprat penale në mjedisin shkollor, aq më e lartë është tendencia për sjellje delikuente të fëmijëve në jetën e përditshme

H<sub>6</sub> - Ekziston ndërlidhje negative mes përdorimit të internetit dhe tendencës për kryerjen e veprave penale

H<sub>7</sub> - Ekziston marrëdhënie negative mes shkallës së kryerjes së veprave penale dhe marrëdhënieve fqinjësore

Struktura e këtij disertacionit të doktoraturës është organizuar në pjesën hyrëse e cila ngërthen në vete fushën shkencore të studimit, argumente pse u ndërmorr studimi, përshkruhet problemi dhe rëndësia e studimit; ndërsa pesë kapitujt përfshijnë: qasjen teorike të problemit të hulumtimit; metodologjinë e studimit; gjetjet e hulumtimit, diskutimet, përfundimin dhe rekomandimet për ndërmarrjen e vepimeve efektive në parandalimin e sjelljeve kriminale, literaturën dhe shtojcat. Punimi i disertacionit përfshinë 60 tabela dhe 29 grafikone.

Në kapitullin e parë *Qasja teorike e problemit të hulumtimit* janë trajtuar një sërë tematikash të ndara në nënkapituj ku fillimisht bëhet përkufizimi konceptual i kriminalitetit të fëmijëve; sistemi i drejtësisë për fëmijë; përkufizimi i kufirit të moshës për përgjegësi penale. Më tej janë trajtuar kuptimi i sanksioneve penale ndaj fëmijëve sipas legjislacionit kombëtar; llojet, qëllimi, zgjedhja dhe shqiptimi i tyre. Po ashtu në këtë pjesë të punimit janë paraqitur studime të ngajaçhme që kanë trajtuar këtë dukuri. Kjo pjesë e punimit ngërthen në vete edhe etiologjinë si qëllim kryesor të studimit Në vijëmësi diskutohet fenomenologja e kriminalitetit të fëmijëve që synon të japë pasqyrë të qartë të formave, shtrirjes dhe strukturës së kësaj dukurie në vendin tonë. Në fund është pasqyruar parandalimi primar, sekondar dhe terciar i kriminalitetit të fëmijëve si dhe roli i organeve kompetente në parandalimin e saj,

Kapitulli i dytë ***Metodologja e studimit*** përbledh në vete dizajnin e hulumtimit të metodës sasiore dhe cilësore, qëllimi dhe objektivat e studimit sasior, pyetjet kërkimore dhe hipotezat e studimit, përcaktimin e variablate të studimit, popullata dhe përzgjedha e mostrës, analiza përshkruese e kampionit të përfshirë në studim, instrumenti matës, përbajtja e pyetësorit, mbledhja dhe analiza e të dhënave, vlefshmëria dhe besueshmëria e studimit. Në këtë pjesë përfshihet edhe metodologja e studimit cilësor, qëllimet e studimit cilësor, kampioni i studimit cilësor, analiza përshkruese e kampionit të përfshirë në studim, instrumentet e studimit cilësor dhe mbledhja e të dhënave. Në përfundim të kapitullit diskutohen aspektet etike dhe kufizimet e studimit cilësor dhe sasior.

Kapitulli i tretë ***Rezultatet e studimit*** kandidatja prezanton rezultatet e përpunuara të këtij studimi për të bërë testimin dhe verifikimin e hipotezave të studimit i cili shoqërohet me analizat përkatëse statistikatore. Në këtë kapitull përshkruhen dhe analizohen statistikisht gjetjet nga studimi për ndikimin e faktorëve të rrezikut dhe tendencën për kryerje të sjelljeve kriminale. Përveç kësaj, në këtë kapitull bëhet analiza e të dhënave cilësore të përsituara nga intervistën gjysëm të strukturuar me fëmijët të cilëve iu është shqiptuar sanksioni penal Referim në Shtëpinë edukuese përmirësuese dhe intervistën e strukturuar me ekipin profesional në Shtëpinë edukuese përmirësuese.

Kapitulli i katërt ***Diskutimi I gjetjeve***, përblidhen gjetjet më të rëndësishme të studimit sasior dhe cilësor krahasuar me gjetjet nga studime të ngajshme që kanë trajtuar këtë problem.

Kapitulli i pestë ***Përfundime dhe rekomandime***, paraqet në mënyrë të sintetizuar përfundimet kryesore të këtij punimi si dhe jep rekomandime të mbledhura nga gjetjet empirike të studimit, analiza e literaturës dhe burimet dytësore si dhe sugjerimet për kërkime të mëtejshme me faktorë të tjera që nuk janë qenë pjesë të këtij studimi.

Sekzioni i ***Literaturës***, përmban burimet e literaturës, të cilat janë përdorur për shtjellimin teorik të këtij studimi.

Në fund, ***Shtojcat***, përbledhin instrumentet e përdorura për hulumtimin sasior dhe cilësor. Po ashtu në këtë kapitull janë paraqitur kërkesat dhe leja e Drejtorisë për ekzekutimin e sanksioneve për hulumtimin e temës.

### **Përshkrim i shkurtër i metodave të përdorura:**

Gjatë hartimit të këtij punimi doktorate, me titull “**Shkaqet, format e manifestimit dhe parandalimi i kriminalitetit të fëmijëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut**” kandidataj i është përmbajtur respektimit të standardeve metodologjike në punën e saj kërkimore-shkencore.

Metodologjia e përdorur në këtë disertacion e zhvilluar në tri fazë mbështetet në studime cilësore dhe sasiore, ndërsa për mbledhjen e të dhënave janë përdorur tri instrumente: një pyetësor dhe dy intervista të strukturura. Përdorimi i të dy metodave është përcaktuar me qëllim që të merren më shumë të dhëna dhe për të zgjeruar më shumë kuptimin për fenomenet dhe për të kontribuuar në teoritë e ndryshme, pasi që përshkrimi fenomenit dhe dukurisë së kriminalitetit te fëmijët vetëm përmes të dhënave sasiore nuk është i mjaftueshëm, andaj këto dy metoda jepin një pasqyrë më të qartë për shpjegimin e fenomenit dhe pëcaktimin e marrëdhënieve mes faktorëve.

Metoda e studimit sasior është përdorur si metodë kryesore, e cila ka ofruar të dhëna në lidhje me vlerësimin e perceptimeve dhe informacioneve nga nxënësit rrëth ndikimit të faktorëve nga fusha personale, bashkëmoshatarëve, shkollës, komunitetit dhe faktorëve tjerë në nxiti të sjelljeve antisociale dhe kriminale si dhe format me të cilat këto sjellje më së shumti janë manifestuar.

Ky studim është joeksperimental korrelacional mes faktorëve nga fusha e familjes (struktura familjare, punësimi i prindërve; raporti dhe mbështetja emocionale dhe kujdesi prindëror; abuzimi i fëmijëve, kontrolli prindëror; historia kriminale e prindërve, përfjetimi i ngjarjeve të rënda në familje), personale (përfjetimi I kërcënimeve dhe dhunës); siguria në shkollë; përdorimi i internetit; fusha e bashkëmoshatarëve (sjellje antisociale të bashkëmoshatarëve, përfshirja në banda); fusha e komunitetit (siguria në lagje; reagimi i komunitetit ndaj sjelljeve të fëmijëve në studim) me shkallën e tendencës për kryerjen e veprave penale.

I dizajnuar në mënyrë që të vlerësojë faktorët e rrezikut me qasje sasiore, ka synuar që përmes perceptimit të nxënësve të gjendet ndikimi i faktorëve të rrezikut të cilët kontribuojnë në shfaqjen e sjelljeve kriminale. Në këtë drejtim, është përdorur një pyetësor i cili ka përfshirë nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të moshës 14-18 vjeçare për mbledhjen e të dhënave.

Të dhënat e mbledhura janë përpunuar përmes paketës statistikore SPSS. Përdorimi i statistikave është realizuar në përputhje me kushtet e përdorimit dhe natyrës së hipotezave të

studimit. Shkalla e lirisë me të cilën janë konfirmuar hipotezat është përdorur niveli .05. Përgjatë përpunimit statistikor janë përdorur:

1. Statistikat përshkruese për prezencën e frekuencave dhe vlerave të qendërzimit për analizat një variablshe
2. Testet e shpërndarjes
3. Analiza e korrelacionit për gjetjen e marrëdhënieve mes shkallës së tendencës për vepra kriminale te fëmijët dhe faktorëve të tjerë. Koeficienti i Pearsonit dhe Spearman-it.
4. Analiza e krahasimit të mesatareve me testin t për krahasimin e grupeve të pavarura
5. Analiza e variancës (Anova) për krahasimin e mesatareve
6. Alpha Cronbach për interkorelacionin e pyetjeve të shkallëve

Studimi cilësor në anën tjetër ofroi të dhëna/pikëpamje mbi faktorët e rrezikut, zgjerim të njohurive për dukuritë e kriminalitetit, njohuri për format e manifestimit të veprave penale nga fëmijët që u është shqiptuar masa ‘Referim në Shtëpi edukuese-përmirësuese’ dhe ekipi profesional në Shtëpinë edukuese-përmirësuese i përbërë nga psikolog, pedagog dhe punëtor social, studim ky i cili u përdorë si metodë ndihmëse që të verifikoj dhe faktojë të dhënat e nxjerrura nga metoda sasiore dhe dhënen e rekomandimeve për masat për parandalim/risocializim të fëmijëve.

#### **Përshkrim i shkurtër i rezultateve të hulumtimit:**

Studimi sasior dhe cilësor mbi shkaqet e kriminalitetit të fëmijëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut tregoi se rrethanat që çojnë në kriminalitetin e fëmijëve nuk ndryshojnë shumë nga shkaqet e njohura të kësaj dukurie, të cilat mund ti sistemojmë në disa kategori, edhe atë: faktorë individual, familjes; shkollës, bashkëmoshatarët, masmedia, lagjja, si dhe dukuritë sociopatologjike si faktorë rreziku. Më poshtë janë shtjelluar të arriturat përfundimtare nga ky hulumtim shkencor.

Me rritjen e raporteve të mira familjare ka ulje të veprave kriminale te fëmijët. Fëmijët të cilët deklarojnë se kanë raporte të mira me prindërit e tyre por edhe kanë mbështetje emocionale dhe perceptojnë se kanë kujdes nga prindërit shprehin nivel më të ulët për vepra kriminale. Monitorimi i fëmijëve jashtë shtëpie nga ana e prindërve redukton tendencën e shfaqjes së sjelleve kriminale të fëmijëve.

Struktura familjare e fëmijëve nuk shfaqet si faktorë i rëndësishëm në paraqitjen e veprave kriminale te fëmijët. Pavarësisht se fëmijët jetojnë me një prind ose me të dy prindërit, tendenca e shfaqjes së sjelljes kriminale ngelet e njëjtë. Megjithatë, të ardhurat familjare janë tregues të shfaqjes së sjelljes kriminale të fëmijëve. Me zvogëlimin e të ardhurave familjare paraqitet rritje e tendencës për vepra penale te fëmijët.

Fëmijët me prindër të punësuar tregojnë tendencë më të lartë për sjellje kriminale për dallim të fëmijëve me prindër jo të punësuar rregullisht. Diferencën e tendencës së shfaqjes së sjelljes kriminale e bëjnë fëmijët të cilët kanë nëna të punësuara rregullisht.

Përjetimi i ngjarjeve traumatike në familje rezultojnë të paraqiten në lidhshmëri me tendencën e shfaqes së sjelljes kriminale te fëmijët. Rritja e perceptimit të përjetimit të ngjarjeve traumatike si sëmundja apo vdekja e prindërve dhe sjelljet problematike me prindër konsumues alkooli apo substanca narkotike shfaqin rritje të tendencës për pjesëmarrje në vepra penale. Gjithashtu, rritja e përjetimit të dhunës verbale dhe joverbale te fëmijët rrit tendencën e pjesëmarrjes së tyre ne vepra penale.

Frekuentimi i mjedisit shkollor ku ka rritje të theksuar të veprave penale nga ana e fëmijëve rrit tendencën për përfshirje ne vepra penale. Në të njëjtin drejtim shfaqet tendenca e paraqitjes së veprave penale edhe me banim/frekuentim të lagjeve nga fëmijët në të cilat ka te shprehur sjellje devijante dhe/ose prezencë të lartë të kryerjes së veprave penale. Për më tej, shoqërimi më i shpeshtë me bashkëmoshatarë të cilët shprehin sjellje delikuente rrisin edhe shfaqjen e tendencës për pjesëmarrje ne vepra penale.

Varësisht qëllimit dhe përbajtjeve të cilat konsumohen nga interneti egziston tendencë e ndryshme për paraqitje të veprave penale. Me përdorim të përbajtjeve mësimore ekziston shprehje me e ulët e veprave penale te femijët, kurse me përdorim të përbajtjeve “problematike” si bixhoz, lojëra fati e të ngjashme ka rritje të tendecës së shprehjes së veprave penale.

Fëmijët meshkuj tregojnë tendencë dukshëm më të lartë për të kryer vepra penale për dallim të fëmijëve femra. Këtë e dëshmojnë të dhënrat statistikore në nivel shtetëror si dhe rezultatet e studimit sasior dhe cilësor.

Sipas të dhënavë të marra nga Enti shtetëror statistikor, në dhjetëvjeçarin e fundit, në Maqedoninë e Veriut, në strukturën e krimit të fëmijëve, dominojnë krimet kundër pasurisë, por në rritje janë dhe krimet kundër shëndetit të njeriut. Me përfaqësim pothuajse të njëjtë janë veprat penale kundër jetës dhe trupit dhe veprat penale kundër rendit publik, megjithëse këto të

fundit shënojnë ulje. Pjesëmarrës në sjellje kriminale dominant janë gjinia mashkulllore, kryesisht të moshës 16-18 vjeç. Sipas nivelistës arsimimit dominojnë fëmijët të cilët janë jashtë procesit edukativo-arsimor, ndërsa bazuar në të dhënrat sipas kushteve familjare, pjesa më e madhe e fëmijëve të dënuar jetojnë me prindërit e tyre.

### **Kontributet kryesore shkencore të kandidatës:**

Konsiderojmë se kandidatja ka dhënë kontribut të duhur në analizën e detajuar në punimin e disertacionit dhe se ky punim shkencor do të kontribuojë në fushën e drejtësisë për fëmijët në Republikën e Maqedonisë së Veriut, sepse eksploroni është mënyrë të thelluar karakteristikat etiologjike dhe fenomenologjike të kriminalitetit të fëmijëve, sublimon kuptimet teorike për kriminalitetin e të miturve, zbatimin në praktik dhe në bazë të përfundimeve jepen propozime në kuptimin de lege ferenda dhe rekomandime që kanë për qëllim gjetjen e mekanizmave për të luftuar në mënyrë më efektive këtë dukuri në vendin tonë.

### **Hulumtime të mundshme në të ardhmen:**

Në bazë të përfundimeve të nxjerra nga studimi i realizuar nga kandidatja Mr.sc. Nazmije Shaqiri me titull “**Shkaqet, format e manifestimit dhe parandalimi i kriminalitetit të fëmijëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut**” për studime të mëtejshme rekomandohet:


1. Të bëhen hulumtime më të thelluara që do të përfshinin variabla të tjera të cilat kanë qenë e pamundur të përfshihen në një studim të vetëm. Andaj, për studime të mëtejshme sugjerohet që të analizohen edhe faktorë tjerë rreziku siç është përdorimi i substancave narkotike nga subjektet që do të përfshihen në studim, sepse është shqetësues fakti se pjesa më e madhe e fëmijëve në konflikt me ligjin rezultuan se kanë qenë përdorues të substancave narkotike. Poashtu, studime më të thelluara mund të realizohen për shfrytëzimin e kohës së lirë dhe ndikimi i saj në kriminalitetin e fëmijëve si dhe rekomandohet të bëhen hulumtime për bullizmin në shkolla dhe roli e tij në paraqitjen e sjelljeve kriminale të fëmijëve.
2. Ky studim rekomandohet që të shtrihet në të gjitha qytetet e Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe të përfshijë më shumë shkolla fillore dhe të mesme, për të realizuar hulumtime më të thelluara në lidhje me faktorët e rrezikut që kontribuojnë në kriminalitetin e fëmijëve.

### Vlerësim dhe propozim

Nisur nga vlerësimet e mësipërme Komisioni shkencor për vlerësimin e dorëshkrimit të temës së doktoratës “**Shkaqet, format e manifestimit dhe parandalimi i kriminalitetit të fëmijëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut**”, të kandidates Mr. sc. Nazmije Shaqiri, konstaton se punimi në fjalët i plotëson të gjitha kushtet të parapara me Rregulloren për kushtet, kriteret dhe rregullat e regjistrimit dhe studimit në ciklin e tretë të studimeve-studimet e doktoraturës në Universitetin e Tetovës dhe ka nderin që t'i propozoj Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Juridik miratimin e këtij raporti dhe krijimin e kushteve përmbrojtjen publike të kësaj teme të doktoratës.

#### **Komisioni:**

1. Prof. Dr. Qebir Avziu, (Kryetar)
2. Prof. Dr. Arta Bilalli, (anëtar)
3. Prof. Dr. Fatbardha Ismaili, (anëtar)
4. Prof. Dr. Ali Musliu, (anëtar)
5. Prof. Dr. Afrim Osmani, (Mentor)

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Afrim Osmani", is placed next to the list of names.

Tetovë, Korrik 2023